



Mapecfloor System 51

SISTEM EPOKSID NE DISPERSION UJOR, OPAK, ME SHUME SHTRESA, I PERSHKUESHEM NGA AVULLI, PA SOLUCIONE TRETESE, PER DYSCHEME INDUSTRIALE ME TRASHESI 3 mm

Produktet e perdorura: MAPEFLOOR I 500 , QUARZO 0.5



PERSHKRIMI

MAPEFLOOR SYSTEM 51 eshte nje sistem epoksid me shume shtresa. Me kete sistem eshte e mundur te lyhen dyscheme industriale, te cilat perftojne rezistence te larte kimike, papershkueshmeri ndaj vajrave dhe elementeve agresive, rezistence te larte ndaj lavazheve te vazhdueshme dhe levizjeve te kembesoreve dhe mjeteve me rrota. Dyshemete e trajtuara me **MAPEFLOOR SYSTEM 51** kane pamje te bukur estetike, nuk jane te rreshqitshme, nuk permbajne solucione tretese dhe jane pa arome.

FUSHAT E PERDORIMIT

Aplikimi i **MAPEFLOOR SYSTEM 51** behet ne dyscheme industriale me trafik normal dhe te renduar, si: magazina, zona te depozitimit te mallrave, parking dhe garazhe te mbuluar, zona te levizjes se kembesoreve dhe mjeteve me rrota.

MAPEFLOOR SYSTEM 51 eshte i pershtatshem edhe per parking dhe garazhe nentokesore dhe eshte i aplikueshem mbi sipërfaqe betoni pas vetem 4 ditesh nga hedhja e betonit.

MAPEFLOOR SYSTEM 51 perdoret ne:

- Industrine kimike dhe farmaceutike, ne zonat magazinimit
- Ne ambiente sterile, laboratore dhe spitale, ne zonat e depozitimit
- Ne magazina te mekanizuara, ne te gjitha zonat
- Ne qendra tregtare, ne zonat me trafik te renduar kembesoresh dhe ne zonat e depozitimit te mallrave
- Industrine ushqimore, ne zonat e magazinimit dhe ne zonat ne trafik te lehte
- Ne ambiente te ftohta, ne zonat e depozitimit te mallrave
- Ne kantina dhe depozita, ku suporti ka permbajtje te larte lageshtire

AVANTAZHET

- Efekti kunder rreshqitjes
- I pershkueshem nga avujt e ujit
- I sigurte per ambientin, sepse eshte produkt me baze ujore dhe nuk permban solucione tretese
- I qendrueshem ndaj kohes, sepse karakterizohet nga rezistence e larte ndaj vjetersimit dhe abrazionit te shkaktuar nga shkeljet dhe lavazhet
- Rezistent ndaj pjeses me te madhe te elementeve kimike, si: acidet baze dhe acidet e holluar, vajrat dhe karburantet



Mapecolor System 51

- lahet lehtesisht dhe nuk ndotet, prandaj eshte mjaft i keshillueshem per industrine ushqimore ne zonat me trafik normal ku levizin kembesoret dhe mjete me rrota
- siperfaqet e trajtuara jane te vazhdueshme, me planaritet te rregullt, me pamje te bukur estetike dhe karakteristika funksionale
- eshte i shpejte dhe i thjeshte per tu aplikuar, dhe redukton kohen e nderprerjes se punes ne impiante
- siguron raport te perkryer cmim-cilesi

REZISTENCA KIMIKE

Dyshemete e trajtuara me **MAPEFLOOR SYSTEM 51** rezistojne ndaj:

- acideve minerale te holluar, si: acid kloridrik, nitrik, fosforik dhe sulfurik. Gjithashtu kane nje rezistence te limituar ndaj acideve organike
- alkaleve, hidroksidit te natriumit me perqendrim 50% dhe detergjenteve te perdorur per pastrimin e dyshemeve me perqendrim 20-30%
- sheqerit, edhe ne kontakt te vazhdueshem

NGJYRAT

MAPEFLOOR SYSTEM 51 eshte i disponueshem ne 19 ngjyra. Ngjyrat jepen ne skeden teknike te **MAPECOLOR PASTE** per **MAPEFLOOR I 300 SL**.

KONSUMI

Te dhenat e konsumit i referohen aplikimit te sistemit ne temperatura nga +15°C deri ne +25°C dhe ne siperfaqe te sheshta dhe kompakte te betonit me finiture kuarci ose te cukitura lehte. Siperfaqet e ashpra dhe temperaturat me te uleta rrisin konsumin dhe zgjasin kohen e tharjes.

Konsumi i shtreses se pare ndryshon ne varesi te tipit dhe te thellesise se pergatitjes se suportit.

MAPEFLOOR SYSTEM 51 per trashesi mesatare 3 mm

Dora e pare: **MAPEFLOOR I 500 W (A+B+MAPECOLOR PASTE)** - 2.5 kg/m²

QUARZO 0.5 - 5.0 kg/m²

Finitura: **MAPEFLOOR I 500 W (A+B+MAPECOLOR PASTE)** - 0.7 kg/m²

Ne rastet kur **MAPEFLOOR I 500 W** eshte i ngjyrosur, nuk shtohet komponenti **MAPECOLOR PASTE**.

PERGATITJA E SIPERFAQES

1. Karakteristikat e suportit

Para aplikimit te sistemit **MAPEFLOOR SYSTEM 51** eshte e nevojshme te behet analiza e suportit qe do te trajtohet. Per nje realizim te perkryer te trajtimit, duhet qe:

- suporti te mos kete rrudha me te medha se 0.3 mm
- suporti te mos kete materiale qe pengojne ngjitjen e produkteve, si:
 - mbetje cemento
 - pluhur dhe pjese te shkeputura
 - produkte te stazhionuara, dyll, parafine, etj
 - njolla vaji ose shtresa rezine
 - mbetje boje ose produkte kimike



Mapecfloor System 51

- Cdo lloj elementi ndotes qe mund te pengoje ngjitjen duhet hequr para fillimit te punimeve. Ne rastet kur suporti eshte i ndotur nga keto elemente, duhet te merren masat qe te pastrohen siperfaqet me metoda specifike

- Rezistenca ne zgjatim e suportit duhet te jete me e madhe se 1.5 N/mm^2

Ne rast se permbushen kerkesat e mesiperme, mund te aplikohet **MAPEFLOOR SYSTEM 51** ne dysHEME industriale betoni, mbi masete me baze cemento ose te modifikuar me polimere, mbi masete me tkurje te kontrolluar te pergatitur me **MAPECEM** ose **TOPCEM**.

2. Pergatitja e suportit

Nje siperfaqe e pergatitur mire, eshte elementi kryesor per te siguruar nje aplikim perfekt dhe per te garantuar karakteristikat e **MAPEFLOOR SYSTEM 51**. Metoda e keshilluar per pergatitjen e suportit eshte menyra me kukitje siperfaqesore. Per pastrimin e siperfaqes nuk jane te keshillueshme menytrat kimike, si lavazhet me acide, ose menytrat me goditje, qe mund te demtojne suportin. Demtimet e suportit, si gropat e vogla dhe plasaritjet, riparohen duke perdorur **EPORIP**, **PRIMER SN** ose **MAPEFLOOR I 500 W** ne varesi te permasave dhe thellesise se demtimeve. Ne rastet kur eshte e nevojshme perforcimi i suportit, perdoret **MAPECOAT I 600 W** i holluar. Hollimi dhe konsumi i produktit jane ne varesi te porozitetit te siperfaqes. Ne rastet kur suporti ka gropa ose demtime me te medha, suporti riparohet me **MAPEFLOOR EP 19** (llac eposidik me tre komponente) ose me produkte te linjes **MAPEGROUT**.

Mungesa e ketyre kushteve te domosdoshme, sjell cilesine e dobet te punimeve.

3. Verifikimi paraprak i aplikimit

Pasi sigurohet qe suporti te jete pergatitur dhe te permbushë karakteristikat e lartpermendura, verifikohet qe temperatura e ambientit te jete me madhe se $+8^\circ\text{C}$ (temperatura ideale eshte $+15$ - $+25^\circ\text{C}$) dhe temperatura e suportit mbi piken e kondensimit te jete te pakten $+3^\circ\text{C}$.

4. Pergatitja dhe aplikimi i produkteve

Pergatitja dhe aplikimi i produkteve behet sipas pershkrimeve ne skedat teknike te produkteve.

• Primer (MAPEFLOOR I 500 W)

Hidhet komponenti A (2 kg) ne komponentin B (24 kg), shtohet ngjyruesi **MAPECOLOR PASTE** dhe perzihen me trapano me numer te vogel xhirosh, derisa te perftohet nje perzierje homogjene. Perzierjes i shtohet 2 lt uje dhe vazhdohet te perzihet derisa te perftohet nje perzierje e re homogjene. Perzierja hidhet mbi dysHEME dhe shperndahet me shpatull amerikane ne menyre uniforme. Kur materiali eshte akoma i fresket, hidhet **QUARZO 0.5** ne forme pluhuri.

• Heqja e pluhurave dhe ashpersimi i siperfaqes

Pasi te jete ngurtesuar shtresa e **MAPEFLOOR I 500 W**, hiqet rera e tepert me thithese pluhurash industriale. Behet ashpersimi i siperfaqes dhe hiqen pluhurat e mbetura.

• Finitura (MAPEFLOOR I 500 W)

Hidhet komponenti A (2 kg) ne komponentin B (24 kg), shtohet ngjyruesi **MAPECOLOR PASTE** dhe perzihen me trapano me numer te vogel xhirosh, derisa te perftohet nje perzierje homogjene. Perzierjes i shtohet 2 lt uje dhe vazhdohet te perzihet derisa te perftohet nje perzierje e re homogjene. Perzierja hidhet mbi dysHEME dhe shperndahet me shpatull amerikane ne menyre uniforme. Pas kesaj, behet shperndarja me rul, ne menyre qe te behet sa me uniforme finitura e shtreses.

Mapecfloor System 51

5. Tharja dhe kalueshmeria

Siperfaqet e trajtuara me **MAPEFLOOR SYSTEM 51**, ne nje temperature +25 °C, mund te shkelen me kembe dhe kalohen pas vetem 16 oresh. Per kalimin e karrocave te lehta dhe mjeteve te tjera levizese duhet te pritet nje dite nga aplikimi i dores se fundit. Ne temperatura me te uleta, kohet e tharjes dhe te kalueshmerise rriten me teper.

PASTRIMI DHE MIREMBAJTJA

Pastrimi dhe mirembajtja e rregullt shton jetegjatesine e siperfaqeve te trajtuara me **MAPEFLOOR SYSTEM 51**, permireson aspektin estetik dhe redukton akumulimin e papastertive. Zakonisht siperfaqet e trajtuara me **MAPEFLOOR SYSTEM 51** lahen lehtesisht me detergjente alkaline te holluar me uje. Gjithashtu ka edhe detergjente te pershtatshem per pastrimin e dysHEMEVE me rezine.

SHENIME

Te dhenat e sigurise jepen ne skedat e sigurise te cdo produkti qe perben sistemin **MAPEFLOOR SYSTEM 51**. Megjithate, eshte e keshillueshme, qe perdoruesit te perdorin doreza dhe syze mbrojtese gjate perzierjes dhe aplikimit te produkteve.

TE DHENAT TEKNIKE (pas 7 ditesh, ne temperature +23°C)

Ngjitja (DIN ISO 4624)	> 1.5 N / mm ²
Rezistenca ndaj abrazionit (TABER CS 17)	85 mg
Koeficienti i bymimit termik (DIN 53752)	16x10 ⁻⁵ °K
Rezistenca ne shtypje (DIN EN 196)	75 N / mm ²
Rezistenca ne perkulje (DIN EN 196)	30 N / mm ²
Moduli i elasticitetit (DIN 1048)	6000 N / mm ²
Rezistenca ndaj temperatures se ajrit	-20°C - +60°C
Aspekti i jashtem	opak dhe jorreshqites